



THIRRJE PËR POZICION TË LIRË PUNE

Pozicioni: Inspektor i avionëve pa pilot/dron në Drejtorinë e Standardeve të Fluturimit

1. Cfarë po kërkojmë ne?

Autoriteti i Aviacionit Civil ka për qëllim rekrutimin e profesionistëve të fushës dhe përthithjen e talenteve të reja në kuadër të rritjes së kapaciteteve.

Në këtë thirrje Autoriteti i Aviacionit Civil kërkon të rekrutojë të rinjë të talentuar dhe të apasionuar në fushën e droneve.

2. Detyrat e pozicionit të punës

- a) Merr masat e nevojshme për vendosjen e standardeve të regjistrimit dhe operimit avionëve pa pilot në Shqipëri (sipas kërkesave të ICAO/EASA)
- b) Përgatit mjetet e nevojshme për regjistrimin dhe mbikëqyrjen efikase të avionëve pa pilot sic janë Manuali i Inspektorëve, Listat e Kontrollit, Format e Auditit si dhe i bëjnë ato lehtësisht të disponueshme në sektor.
- c) Siguron mbikëqyrje të vazhdueshme për avionët pa pilot të regjistruar në regjistrin e avionëve pa pilot në Republikën e Shqipërisë, në mënyrë që të sigurohet që ata të ruajnë standardet e kërkuara të sigurisë ne operim të specifikuar nga ACAA.

3. Kërkesat e pozicionit të punës

- a) Edukimi: Diplomë Master i Shkencave në degët e Aeronautikës, në Inxhinieri Elektronike, Inxhinieri Telekomunikacioni, Inxhinieri Informatike.
- b) Gjuhë e huaj : Anglisht Niveli B2 (ose ekuivalente)
- c) 1 vit eksperiencë në fushë *fusha lidhet me degën e studimeve

4. Dokumentacioni për dorëzim

- a) Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip të vënë në dispozicion nga Autoriteti.
- b) Diplomë Bachelor dhe/ose master e noterizuar.
- c) Fotokopje e librezës së punës.
- d) Vërtetim i gjendjes shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse.
- e) Vërtetim i gjendjes gjyqësore.
- f) Çdo dokumentacion tjetër që vërteton mesataren e ponderuar të diplomës (listë notash, vërtetim nga fakulteti), trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim.

5. Aftësi të tjera

- a) Aftësi shumë të mira komunikuese
- b) Aftësi organizative
- c) Aftësi për të punuar në grup

MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen për edukimin, përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën.

Totali i pikëve për vlerësimi e kandidatëve është **100 pikë** i detajuar si më poshtë:

Vlerësimi maksimal për dokumentacionin është **40 pikë**

Vlerësimi maksimal për intervistën me gojë është **60 pikë**

Kandidatët që marrin të paktën 60 pikë në vlerësimin e përgjithshëm renditen te lista e pritjes

SHPALLJA E REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, (vlerësimi i dokumentacionit dhe intervistës me gojë) Njësia e Burimeve Njerëzore në Autoritetin e Aviacionit Civil do të shpallë fituesit në faqen e tij të internetit. Kandidatët jo fitues kanë të drejtë të ankimohen pranë Njesisë së Burimeve Njerëzore të Autoritetit. Afati i ankimit është **5 ditë** nga data e shpalljes së rezultatit përfundimtar.

Nëse mendoni se plotësoni kriteret e mësipërme Autoriteti i Aviacionit Civil ju fton të aplikoni në adresën zyrtare rekrutime@acaa.gov.al

Vetëm aplikantët të cilët kanë përmbushur kriteret e përcaktuara në shpallje do të njoftohen për intervistë.